



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1411/1 Prot.

Tiranë, më 07/06/2022

V E N D I M

Nr. 12, datë 07.06.2022

“PËR

**MIRATIMIN E FILLIMIT TË PROCEDURËS SË VLERËSIMIT DHE AKORDIMIT TË
TITULLIT ‘DOCTOR HONORIS CAUSA’ PËR PROF. DR. ING. THOMAS CAROLUS
NGA UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS”.**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM Nr. 112/2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’”, Kreu V, pika 1, në Rregulloren “Për fitimin e titujve akademikë në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Kreu V, neni 25, me propozimin e Dekanit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, me shkresën Nr. 539/1 Prot., datë 24.11.2020 dhe me pëlqimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, shkresa Nr. 5905/1 Prot., datë 22.12.2021, Senati Akademik në mbledhjen e datës 07.06.2022,

VENDOSI:

T’i akordojë titullin “Doctor Honoris Causa”:

Prof. Dr. Ing. Thomas Carolus

Për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit dhe shkencës në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maligari

Maligari